



Në bazë të dispozitave të nenit 4.1 dhe nenit 39.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr.2007/30 , të dispozitave të nenit 10 , paragrafi A ,pika 14 dhe 15 dhe të nenit 134 të Statutit të Komunës së Drenasit , të dispozitave të Rregullores për tarifa dhe ngarkesa komunale 01 nr. 031-520 të datës 04.09.2007 dhe në pajtueshmëri me Ligjin nr. 2004/18 mbi tregtinë e brendshme , Kuvendi i Komunës së Drenasit , në mbledhjen e mbajtur me 29/04/2008 , miratoi :

## **RREGULLOREN PËR LEJE PUNE TË SUBJEKTEVE AFARISTE**

### **I.DISPOZITAT E PËRGJITHËSHME**

#### **Neni 1**

Me këtë Rregullore përcaktohen kushtet për dhënien e lejes për punë subjekteve afariste për ushtrimin e veprimtarisë së tregtisë në tregun e brendshëm ( tregtisë me shumicë , tregtisë me pakicë) , hotelerisë , ndërtimtarisë, zejtarisë , shërbimeve të tjera profesionale , masat mbikëqyrëse , sanksionet administrative dhe dispozitat përfundimtare.

#### **Përkufizime**

#### **Neni 2**

Termet e dhëna në këtë Rregullore do të kenë këtë kuptim :

- **“Shoqëri tregtare”** , do të thotë çdo person apo grup personash që merren me aktivitete tregtare , ekonomike e të cilët janë të mbështetura në ligj dhe akte tjera normative , e më qellim përfitimi ;
- **“Person fizik”** , nënkupton individin ose personin fizik si pronar te ndërmarrjes së regjistruar si biznes individual;

- **“Person juridik”** , nënkupton shoqërinë aksionare , partneriteti ( shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar ) , kompaninë e huaj , ndërmarrjen shoqërore dhe ndërmarrjen publike;
- **“Drejtori ”** , nënkupton Drejtorinë e Financave , Ekonomisë dhe Zhvillimit të Komunës së Drenasit , e themeluar me skemën organizative për organet e administratës komunale ;
- **“Leje e punës “** , nënkupton lejen e lëshuar nga organi kompetent , në pajtim me kushtet e përcaktuara me ligj dhe me këtë rregullore , në bazë të të cilave ushtrohet biznesi i caktuar ;
- **“Lokal afarist”** -lokali i përshtatshëm për zhvillimin e veprimtarisë afariste , si dhe lokalin tjetër të paraparë për një veprimtari të tillë ;
- **“MTI”** Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ;
- **“ Mbikëqyrje inspektuese”**- mbikëqyrja e zbatimit të ligjit, të akteve tjera nënligjore , si dhe marrja e masave administrative dhe masave të tjera me qëllim që parregullsitë e konstatuara gjatë inspektimit të mënjanojnë sipas ligjit ;
- **“Inspektor “**- person zyrtar , me autorizim dhe përgjegjësi të veçantë i cili zbaton mbikëqyrjen inspektuese të afarizmit të personave fizikë apo juridikë

### Neni 3

**3.1** Të gjitha aktivitetet afariste në Komunën e Drenasit duhet të kryhen në vend të caktuar dhe të përshtatshëm , e të cilat i plotësojnë kushtet minimale tekniko – sanitare.

**3.2** Sipas kësaj Rregulloreje asnjë subjekt afarist , nuk lejohet të ushtrojë veprimtarinë afariste pa leje pune të lëshuar nga Drejtoria .

### Neni 4

**4.1** Subjekti afariste që ushtron veprimtarinë në Komunën e Drenasit , duhet të jetë i regjistruar sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/6 për shoqëritë tregtare dhe në bazë të urdhëresave dhe udhëzimeve të tjera të lëshuara nga Instucionet Qendrore te Republikës së Kosovës dhe Komuna e Drenasit .

**4.2** Subjekti afarist që ushtron veprimtarinë biznesore brenda Komunës së Drenasit duhet :

- të ketë lejen e punës për secilën njësi ,
- t'i përmbahet lejes së punës e cila ka karakter personal dhe nuk mund të bartet në personin e tret , përveç rasteve kur kjo është e lejuar me ligj.

## Neni 5

Subjekti afarist , për të marr lejen e punës , kërkesës duhet ti bashkëngjisë :

**5.1** Certifikatën e regjistrimit të biznesit pranë MTI-së , në pajtim me rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/6 , urdhëresat dhe udhëzimet tjera .

**5.2** Lejen e ndërtimit , lejen e përdorimit apo Aktvendimin mbi legalizimin e lokalit afarist të ndërtuar pa leje..

Subjektet afariste të cilat nuk posedojnë lejen e ndërtimit , lejen e përdorimit, lejen e shndërrimit të lokalit banesor në atë afarist apo Aktvendimin mbi legalizimin e lokalit afarist të ndërtuar pa leje , në të cilin e ushtrojnë veprimtarinë , **iu jepet leja e punës , me kushte që brenda një viti të sigurojë lejen përkatëse . Nëse edhe pas skadimit të këtij afati nuk e siguron lejen përkatëse , e njëjta nuk do të vazhdohet.**

**5.3** Provën me të cilën shoqëria e dëshmon pronësinë e lokalit afarist ose kontratën për marrje me qira të lokalit afarist të vërtetuar nga Gjykata Komunale.

**5.4** Nëse objekti afarist është i vendosur në pronën shoqërore apo komunale kontratën për shfrytëzim të tokës si dhe dëshminë mbi pagesën e taksës për m<sup>2</sup> të sipërfaqes së shfrytëzuar sipas Rregullores përkatëse .

**5.5** Pëlqimin e dhënë nga komisioni përkatës komunal për pranimin e lokaleve , se lokali i plotëson kushtet minimale teknike – sanitare për lokal afarist .

**5.6** Provën për pagesën e tarifës komunale për lëshimin e lejes së punës , sipas rregullores për tarifën dhe ngarkesat komunale 01 nr. 031-520 të datës 04.09.2007.

**5.7** Fotokopjen e lejes së njoftimit.

**5.8** Skica e lokalit me sipërfaqe të përgjithshme.

## Neni 6

Drejtoria është e obliguar që në afat prej 30 ditësh , ushtruesit të kërkesës ti jep përgjigje me shkrim për aprovimin apo refuzimin e kërkesës për leje pune .

## Neni 7

Subjektet afariste të cilat pajisen me licencë nga Ministritë përkatëse , obligohen të pajisen me leje pune , por paraprakisht duhet ta paraqesin dokumentacionin e nevojshëm dhe te marrin pëlqimin nga komisioni komunal se lokali i plotëson kushtet minimale teknike-sanitare .

## Neni 8

**8.1** Leja e punës është e përhershme , përveç nëse me ligj të veçantë është paraparë ndryshe.

**8.1~~2~~** Leja e punës duhet të ripërtërihet për çdo 12 muaj , duke ju lëshuar palëve Aktvendimin për ripërtëritje , por paraprakisht subjekti afarist duhet ti ofroj organit kompetent komunal për leje pune dëshminë për pagimin e obligimeve komunale.

**8.2** Tarifa e taksës për leje pune është caktuar prej 20 € , të cilat duhet të paguhen në bankë me rastin e marrjes së lejes së punës dhe organit që e lëshon lejen e punës ti ofrohet dëshmia e pagesës .

**8.3** Nëse përkundër plotësimit të kushteve , pronarit nuk i lëshohet leja nga organi kompetent komunal , inspektori i MTI-së mund të urdhëroj dhënien e lejes për punë .

**8.4** Në rast kur edhe pas urdhrit të inspektorit të MTI-së , nuk i lëshohet leja e punës , ky i fundit lëshon lejen e vlefshme të punës.

## Neni 9

**9.1** Leja e punës do të ndryshojë nëse shoqëria tregtare ndryshon adresën , bëhet ndërrimi i pronarit apo ndërrohet veprimtaria , subjekti afarist në afat prej 7 ditësh duhet ta njoftoj me shkrim Drejtorinë në mënyrë që të ndërrohet leja e më parme dhe të lëshohet leja e re e punës , ku për ndërrim te lejes se punës duhet të paguhet taksa në vlerë prej 10 € dhe organit ti ofrohet dëshmia e pagesës.

**9.2** Afati për ndryshimin e lejes për rastet e përmendura në pikën 1 të këtij neni , është 7 ditë nga dita e ndryshimeve që janë bërë në certifikatën dhe informacionin e saj.

## Neni 10

Gjatë ushtrimin të veprimtarisë pronari është i obliguar që në lokalin afarist , në vend të caktuar të vendos certifikatën e regjistrimit të biznesit dhe lejen

për punë , si dhe ta mbaj evidencën lidhur me blerjen , shitjen dhe çmimet e mallit.

## **II MASAT MBIKËQYRËSE**

### **Neni 11**

Mbikëqyrjen në implementimin e dispozitave të këtij ligji e ushtron inspekcioni i tregut pranë Drejtorisë së inspekcionit.

### **Neni 12**

**12.1** Nëse inspektori i tregut konstaton se aktiviteti afarist nuk është i regjistruar apo nuk posedon leje pune , ai/ajo mund të ndaloj përkohësisht ushtrimin e veprimtarisë afariste deri në eliminimin e këtyre parregullsive.

**12.2** Ankesa në vendim nuk e ndalon ekzekutimin e tij .

### **Neni 13**

**13.1** Nëse inspektori gjatë inspektimit zbulon parregullsi , kurse veprimtaria me shumicë nuk ushtrohet në objektet përkatëse apo depo , ose malli i caktuar blihet në kundërshtim me kushtet e përcaktuar me vendim , mund t'i ndalohet përkohësisht ushtrimi i veprimtarisë afariste ,deri në eliminimin e parregullsive .

**13.2** Ankesa në vendim nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit.

### **Neni 14**

**14.1** Ankesa kundër vendimit të inspektorit të tregut , i drejtohet Inspektoratit të MTI-së në afat prej 15 ditësh nga data e marrjes së vendimit të inspektorit.

**14.2** Vendimi i Inspektoratit të MTI-së merret brenda 60 ditëve nga data e pranimi të ankesës dhe i njëjti mund të apelohej pranë gjykatës përkatëse.

## **III. SANKSIONET ADMINISTRATIVE**

### **Neni 15**

Personi fizik apo juridik gjobitet në shumë prej 3000 € deri me 9000 € nëse :

- a. ushtron veprimtarinë për të cilën nuk është regjistruar, neni 4.1;
- b. ushtron veprimtari pa leje pune në kundërshtim me nenin 3.2 ;
- c. zhvillon veprimtari që nuk përmbush kushtet minimale teknike apo sanitare dhe shëndetësore të përcaktuara sipas nenit 3.1;
- d. nuk mban librat e evidencave ashtu siç është paraparë me nenin 10.

#### Neni 16

Personi fizik dhe juridik gjobitet prej 2000 € deri 6000 € :

Nëse shet mallra në ambient të hapur dhe nuk është i regjistruar pranë MTI-së , respektivisht nuk ka leje për ushtrimin e veprimtarisë ose për shitjen e mallrave të cilat sipas dispozitave të veçanta nuk mund të shiten në ambient të hapur, neni 3.1 , 3.2 , 4.1.

#### Neni 17

17.1 Procedurën për shkelje e udhëheq Gjykata Komunale për kundërvajtje në Drenas.

17.2 Procedurat , udhëheqja e së cilave nuk ka përfunduar , procedohen sipas dispozitave të cilat kanë qenë në fuqi deri në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje

### DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

#### Neni 18

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje , pushon së vlejture Rregullorja për leje pune të subjekteve afariste 01 nr. 330-168, dt. 24.03.2006.

#### Neni 19

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Drenasit.

KUVENDI I KOMUNËS SË DRENASIT

NR. 031-3468 DATË 9 06 08



KRYETARI I KUVENDIT

*[Handwritten signature]*

z. Nexhat Demaku